

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

04.11.2024

Ora 17:02

**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për miratimin e karakteristikave themelore të funksionalitetit të platformës elektronike për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- **Komisioni Rregullator:**
- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar (online)
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Znj. M. Çelmeta, znj. J. Josifi, znj.P. Doçaj
- Parti Politike: PL (z.K. Kolndreu)

**OJQ:**

**KRIIK**

**Znj. I. Nano:** Mirëmbërëma! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator, e cila është njoftuar rregullisht, për sot në orën 17.00. Në mbledhje janë të pranishëm anëtarët e Komisionit Rregullator, katër prej nesh janë prezent në sallë, kolegu ynë Dritan Çaka është i lidhur me ne online. Dritan na dëgjon?

**Z. D. Çaka:** Po, përshëndetje!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

**Znj. I. Nano:** Përshëndetje!

**Z. D. Çaka:** Dëgjohem?

**Znj. I. Nano:** Po. Lidhja me vidion nuk funksionon?

**Z. D. Çaka:** Ju kërkoj ndjesë që do të kemi mundësinë që të jemi vetëm me zë sepse për shkak të problemeve teknike është e pamundur të kem mundësinë për t'u lidhur me figurë. Po besoj, çdo gjykim, votën time, në çdo rast do ta lexoj me zë dhe mund të regjistrohet. Faleminderit!


**Znj. I. Nano:** Dakord, faleminderit! Në mbledhje janë të pranishëm gjithashtu Sekretarja e Përgjithshme e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, zyrtarë të tjerë të administratës dhe kemi vetëm një përfaqësues nga partitë politike, përfaqësuesi i Partisë së Lirisë. Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme kemi një çështje për të shqyrtuar, një projektvendim. Projektvendimi “Për miratimin e karakteristikave themelore të funksionalitetit të platformës elektronike për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Përpara se të fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit, kolegë nëse keni çështje për të diskutuar jashtë rendit të ditës?

**Z. D. Çaka:** Po, e nderuar Kryetare do të doja unë të kisha një diskutim përpara.

**Znj. I. Nano:** Po zoti Çaka, ju dëgjojmë.

**Z. D. Çaka:** Mundem?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

*Znj. I. Nano: Po.*

*Z. D. Çaka:* Faleminderit! Atëherë nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve na është sjellë për shqyrtim sot, pikërisht ky projektvendim “Për miratimin e karakteristikave themelore të funksionalitetit të platformës elektronike për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Më parë me aktin nr.10, të datës 23.10.24 kemi miratuar pikërisht të gjithë procedurën se si do të bëhet regjistrimi i zgjedhësve, që do të votojnë për herë të parë nga jashtë, pra pikërisht në këtë platformën elektronike të regjistrimit, e cila është e përcaktuar dhe si e tillë në nenin 25, të Kodit Zgjedhor. Pikërisht po marr shkas dhe po e nis nga shqyrtimi i aktit të fundit, pra i këtij akti nr. 10 të datës 23 tetor 2024 kur kemi shtruar për diskutim një çështje e cila është ngritur dhe është propozuar nga ana ime në atë mbledhje. Në aktin bazë të sjellë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, i cili më pas u tërhoq, u ripunua dhe u soll i ripunuar. Pra, në këtë të ripunuarin ka qenë në pikën 7, në mos gaboj, të kreut të dytë të tij, pikërisht dhe një aneks ku ishin të përfshira këto karakteristika të cilat sot janë ndarë, janë sjellë në një akt të veçantë, të këtij propozimi të Komisionerit.

*Znj. I. Nano: Zoti Çaka?*

*Z. D. Çaka:* Në atë mbledhje unë kam bërë disa propozime duke e përcaktuar, duke e vlerësuar që Komisioni Rregullator nuk ka kompetencën e dhënë nga Kodi Zgjedhor për shqyrtimin e një akti të tillë dhe kam propozuar që të ishte Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ai i cili ta miratonte këtë akt. Mbi bazën e këtij arsyetimi timin, dhe propozimi, për faktin që nuk jemi në struktura brenda Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që kemi kompetencën për miratimin e këtij akti.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

Unë bëra dhe një propozim konkret, të cilin besoj të gjithë e dimë dhe e kemi të përcaktuar, ku kemi thënë që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miraton akt ose akte, parime dhe karakteristikat të përgjithshme teknike për krijimin, funksionimin, administrimin, mbikqyrjen dhe aplikimin e PER sipas legjislacionit në fuqi. Dua t'i rikthehem atij diskutimi, të cilin më pas ne e kemi normuar nëpërmjet një votimi dhe kemi miratuar pikërisht heqjen e këtij aneksi me specifikime ose me karakteristika konkrete teknike për PER-in. Është votuar më pas dhe ky propozim. Neni 25, pika 5 e Kodit Zgjedhor ka përcaktuar fare qartë që KQZ-ja krijon, mirëmban dhe përditëson pajisjen elektronike të regjistrimit për regjistrimin e kërkesave të zgjedhësve që dëshirojnë të votojnë nga jashtë vendit. Ashtu siç kemi ndjekur të gjithë praktikën e mëparshme, interpretimet, vlerësimet, gjykimet tona, por dhe të strukturave të tjera të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është e përcaktuar, që aty ku nuk është shprehur në mënyrë literale Kodi Zgjedhor për kompetencën e Komisionit Rregullator, pra, që miratohet me akt të Rregullatorit apo nuk është shprehur që miratohet me akt normativ, kompetenca nuk ka qenë e jona. Pikërisht për këtë do të kisha një propozim konkret duke u shprehur të votojmë moskompetencën e Komisionit Rregullator për shqyrtimin e këtij akti dhe ky nuk është akti i parë që ne kemi bërë në të tillë funksion. Ne kemi pasur dhe akte të tjera ku kemi vendosur moskompetencën, kur kemi konstatuar që ajo nuk është e jona, se janë struktura të tjera të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Pikërisht vlerësoj dhe gjykoj që nuk jemi ne, pra dhe një herë, struktura që duhet ta shqyrtojë këtë akt sepse neni neni 25, pika 5, nuk na e ngarkon ne një detyrim të tillë. Për më tepër duhet theksuar që vetë ne në aktin nr.10, të datës 23.10.24 jemi shprehur një herë në lidhje me këtë . Pra, në qoftë se shprehemi me atë termin e përgjithshëm kuptohet që nuk është i barasvlefshëm, po në koncept po. Me atë çfarë gjykon një trupë gjykuese jemi përpara asaj gjësë së gjykuar, sepse ne jemi

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

shprehur që ne kemi në mënyrë literale kreun 2, në pikë në 7 ku kemi thënë në mënyrë eksplicite që do jetë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Madje në diskutimet e bëra dhe nga anëtarë të KQZ, pak a shumë më është mbështetur dhe votuar qëndrimi arsyetimi dhe vlerësimi im, që nuk jemi ne struktura që duhet ta shqyrtojë, pak a shumë këtë nen. Kështu që unë vlerësoj që ne nuk jemi struktura kompetente, për më tepër duhet theksuar që Kodi Zgjedhor ka përcaktuar të ndryshme referencat, terminologjitë, nga ajo cfarë propozon Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Nuk është neni 20, që të gjejë zbatim në këtë rast në vlerësimin tim, ai kur shprehet për sisteme apo pajisje teknologjike sepse në qoftë se legjislatori do kishte pasur për qëllim që të përdorte një ndër këto dy shprehje edhe në lidhje me këtë platformë, nuk do të kishte përdorur një platformë, një term tjetër që është platforma e regjistrimit. Për më tepër duhet theksuar që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kryesisht administrata ka pasur dhe raste të tjera, të ngjashme të krijimit të platformave të cilat nuk kanë kaluar karakteristikat nga ana jonë. Këtu përmendim platformën elektronike për regjistrimin financiar, apo platformën për implementimin dhe marrjen e të dhënave nga pajisjet e votimit të elektronik dhe nxjerrjen e rezultatit, pra platforma të cilat nuk kanë kaluar nga ne. Kështu që unë vazhdoj t'i qëndroj po të njëjtit mendim, vlerësim, gjykim si dhe në mbledhjen e datës 23 dhe votimin që ne kemi bërë. Propozoj që të shqyrtojmë për vendimmarrje kërkesën timen për marrjen e një vendimi për moskompetencën e Komisionit Rregullator, për shqyrtimin e projektaktit të sjellë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Z. Çaka faleminderit! Atëherë, kolegë duke qenë se kemi një propozim të z. Çaka, për të shpallur moskompetencën lidhur me miratimin e aktit, që ka ardhur

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*


dhe e kemi në rendin e ditës do doja më së pari të çelja diskutimin lidhur me këtë propozim. Kolegë?

**Znj. H. Vukaj:** Kjo është çështje brenda rendit të ditës. Verifikimi i kompetencës nuk bëhet në këtë Komision.

**Znj. I. Nano:** Diskutime për këtë propozim të kolegut, për shpalljen e moskompetencës lidhur me miratimin e projektvendimit “Për miratimin e karakteristikave themelore të funksionalitetit të platformës elektronike për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Zonja Vukaj!

**Znj. H. Vukaj:** Mbasi dëgjuam kolegun Çaka, që në fakt ngriti një çështje brenda rendit të ditës dhe jo jashtë rendit të ditës, mendoj që absolutisht jemi organi që e kemi për kompetencë të miratojmë karakteristika të përgjithshme për funksionimin e platformës elektronike të regjistrimit, PER. Ashtu sikundër kemi bërë edhe në aktet, të cilat po ne i kemi miratuar dhe kemi pasur kompetencën e padiskutueshme të provuara për modernizimin apo avancimin e këtij sistemi zgjedhor. Ju e dini që pajisja elektronike e identifikimit ka qenë një dhe pajisja elektronike e votimit ka qenë tjetra. Kemi vlerësuar aktin e ardhur në atë kohë nga Komisioneri, kemi shqyrtuar të gjitha karakteristikat e natyrës normative dhe i kemi miratuar po ne. Kështu që absolutisht këtë akt sot e gjejmë në kompetencën e Komisionit Rregullator. Se çfarë mbetet akt eksplicit për t’u votuar si pjesë normuese nga ana jonë është çështje që do ta vlerësojmë rast pas rasti dhe sipas shqyrtimeve që do t’i bëhen pikave. Për sa i përket pikave të cilat i kapërcejnë natyrën normative dhe janë të karakterit ekzekutiv ose i përkasin një teknike mikro, për të cilën nuk mbajmë dot

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

përgjegjësi sepse s'kemi autorizimin apo formimin profesional t'i përgjigjemi vlerës që mund të ketë karakteristika eksplicite, atëherë do ta vlerësojmë dhe këtë rast pas rasti. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit! Kolegë, z. Çakaj, z. Çela, keni diçka? Në fakt nisur nga propozimi i kolegut Çaka dhe unë doja të theksoja që në mbledhjen e datës 23 kur kemi miratuar rregullat për regjistrimin është diskutuar kjo çështje. Duke pasur parasysh neni 25, pika 5, të Kodit Zgjedhor, sipas të cilit Komisioni Rregullator krijon, mirëmban dhe përditëson platformën elektronike për regjistrimin, pikërisht nga ana e kolegut Çaka është propozuar ai paragraf, që ne e kemi miratuar dhe është pjesë e vendimit nr.10. Pikërisht mbi argumentin që ne nuk kemi autorizim për të miratuar karakteristikat teknike sikundër ishin sjellë në një aneks, në aktin e rishikuar, të risjellë për herë të dytë nga ana e administratës. Në fakt, në këtë mbledhje ka pasur diskutime kryesisht nga kolegët Çaka, Vukaj dhe Çakaj dhe më lejoni, unë kam procesverbalin e mbledhjes. Z.Çakaj ka thënë: “Qoftë nga Rregullatori, qoftë nga Komisioneri me idenë që të kemi një akt me rregulla, pra nuk kemi ndonjë propozim konkret që ta miratojë Komisioni Rregullator”. Znj. Vukaj ka thënë: “Po, kjo mund të zgjidhet me akt të Komisionerit”.

**Znj. H. Vukaj:** A mund të sqaroj pak?

**Znj. I. Nano:** Po.

**Znj. H. Vukaj:** Nga ridëgjimi që i kam bërë mbledhjes dhe nga bindja e brendshme që kam, apo ato çfarë kam deklaruar, i mbetem sërish që jo vetëm kemi kompetencën por votën time kam shprehur pro, në momentin e propozimit të z.Çaka për hir të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

gamës më të gjerë, që u bë me rastin e propozimit. Pra, thamë KQZ dhe nuk thamë në mënyrë eksplicite Komisioni Rregullator, pasi e dimë shumë mirë që ne kemi tagër, atribut dhe kompetencë të miratojmë akte me karakter normativ, pra rregulla të karakterit normativ dhe jo ekzekutiv. Pra, ashtu sikundër kemi bërë me dy pajisjet e tjera elektronike dhe këtë e kam cituar për referim edhe në mbledhjen e kaluar dhe ndaj ndryshova opinionin, ku nëse ju kujtohet ju bëra thirrje, kolegë ta votojmë aktin dhe propozimin edhe ashtu siç ishte duke, më pas, retushuar rast pas rasti kur të kalonim në shqyrtim të secilit rregull. Pra, duke mbajtur për rregulla të karakterit normativ ato që ishin rregulla të tilla dhe duke nxjerrë jashtë natyrës tonë rregulla të cilat e kapercenin normën e të qenit normative.

**Zj. I. Nano:** Pikërisht. Po zoti Çakaj!

**Z. M. Çakaj:** Faleminderit zonja Kryetare! Faleminderit administratës, që është kaq e përpiktë në regjistrimin e thënieve. E dëgjova me vëmendje atë çfarë kam deklaruar dhe e rikonfirmoj po të njëjtin qëndrim. Në gjykimin dhe vlerësimin tim është shumë e rëndësishme, pra përtej çështjes së kompetencës, është shumë e rëndësishme që ne të miratojmë disa rregulla mbi të cilat do të krijohet një platformë elektronike, në rastin konkret PER, platforma elektronike e regjistrimit. E cila do të shërbejë si shtrat elektronik për të bërë administrimin e gjithë kërkesave për regjistrim në listën e zgjedhësve nga jashtë vendit. Rikonfirmoj qëndrimin tim, që pak rëndësi ka se kush e miraton. Komisioneri tashmë e ka vlerësuar, referuar edhe nenit 20 të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohen kompetencat e Komisionit Rregullator dhe konkretisht një nga kompetencat është që Komisioni Rregullator miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së për rregullat, për administrimin e votuesve nga jashtë vendit, mbi llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

plotësojnë sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit që prokurohen dhe përdoren për zgjedhjet në Republikën e Shqipërisë, për rregullat për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve teknologjisë së informacionit, të domosdoshme për të siguruar përdorimin e ligjshëm, të rregullt, transparent, efikas dhe të qëndrueshëm të tyre. Mesa duket, unë do t'i shtoja relacionit edhe dispozitën ligjore përkatëse, referuese të vendimit nr.10. Me anën e të cilit, se nuk e gjej këtu, është referuar neni 20 i Kodit Zgjedhor, është referuar neni 25, pika 5 e Kodit Zgjedhor, po në gjykimin dhe vlerësimin tim, ajo dispozitë referuese e vendimit nr.10, në mos gaboj kreu 3/2, është një dispozitë autorizuese e cila do të shërbente si bazë, do duhej të citohej në relacion. Megjithatë në gjykimin dhe vlerësimin tim dhe unë jam pro miratimit të këtij akti, për t'i hapur rrugë procesit. Pak rëndësi ka kush e miraton. Në rastin konkret për t'i dhënë zgjidhje procesit, meqë kolegët e mendojnë që kjo çështje nuk është në kompetencën tonë, nëse nga ana e administratës apo Komisionerit rivlerësohet qëndrimi për ta marrë vetë, dakord. Shumë e rëndësishme është që të vijojë procesi, nuk kam asgjë.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit z. Çakaj! Lidhur me këtë që sapo z.Çakaj propozoi dëshironi të merrni një komunikim?

**Znj. H. Vukaj:** Një pyetje kam për administratën. Pasi ju përmblohdhët të gjithë këto rregulla teknike të karakterit normativ apo ekzekutiv, kjo është çështje që vlen për t'u diskutuar. A vlerësuat fillimisht ose parimisht se kompetenca është e ndarë? Pikërisht është ky neni që keni përdorur si referencë në relacionin tuaj, njëkohësisht dhe në draftin e ardhur si projektvendim, neni 20, pika 1, shkronja "dh" e Kodit Zgjedhor. Pra, jeni të bindur se është kjo referenca? Apo e bën dyshues aktin e propozuar?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

**Znj. J. Josifi:** Kur propozuam projektvendimin e parë për miratimin e rregullave për regjistrim dhe listës së zgjedhësve nga jashtë vendit, po flas për projektvendimin e parë, jo ai në vijim të diskutimeve u tërhoq nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Ne pamë se nuk kishte një autorizim ligjor në Kod për të patur një akt tjetër nënligjor, i cili do të hynte shumë në detaje të platformës sepse menduam që rregullat ezauroheshin me projektaktin “Për miratimin e rregullave të regjistrimit”. Në bazë të diskutimeve të zhvilluara nga ana juaj si anëtarë të Komisionit Rregullator, edhe të propozimeve të tjera që erdhën, Komisioneri e tërhoqi atë projektvendim dhe solli një projektvendim tjetër, i cili kishte të atashuar lidhjen 1, që ishin pikërisht rregullat teknike të përdorimit të platformës PER, meqë një gjë e tillë u kërkua nga ana juaj.

**Znj. H. Vukaj:** Ju lutem më thjesht, a mendoni se është ende kjo dispozitë e vlefshme? Pra kompetenca është e Komisionit Rregullator?

**Znj. J. Josifi:** Po.

**Znj. H. Vukaj:** Këtë dua ta konfirmojë dhe Drejtoresha Juridike, meqenëse është prezent aty, apo është e Komisionerit dhe pastaj ju tërhiqni aktin.

**Znj. P. Doçaj:** Ne përderisa e kemi sjellë për miratim tuaj dhe jemi bazuar pikërisht në këtë nen, mendojmë që është kompetencë e Rregullatorit dhe enkas kemi përdorur bazën ligjore që ju sapo cituat.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

**Znj. H. Vukaj:** Meqenëse jemi në kohë, kolegët tanë po e shtrojnë për diskutim, ju mund ta tërhiqni dhe ta ridiskutoni këtë çështjen e kompetencës.

**Znj. P. Doçaj:** Jemi të bindur përderisa e kemi propozuar këtë akt për miratimin tuaj, i qëndrojmë në tërësi bazës ligjore dhe asaj çfare kemi relatuar.

**Znj. H. Vukaj:** Pra dhe nëse do të ripërsëris thirrjen tani, ka vend për ta tërhequr dhe për ta riparë që kjo kompetencë t'i kalojë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve? Me këtë rast aty vlerësoni dhe natyrën e atyre gjithë rregullave që keni propozuar, të cilat po t'i hysh gjen rregulla të përziera. Në të njëjtën kohë, duhet të kishte dhe një relacion apo një akt ekspertize nga një grup pune që e ka punuar, etj. Të cilët marrin përsipër që janë këto rregulla dhe nuk ka të tjera më të mira se këto. Për një akt të mirë them, që jep besueshmëri palëve dhe u jep garanci palëve.

**Znj. J. Josifi:** Po e nis nga e fundit, relacioni, por edhe projektakti është sigluar nga të gjithë Drejtoria që e ka detyrë funksionale këtë proces, që janë praktikisht gjithë grupi i punës lidhur me këtë proces, të kësaj platforme, pra të regjistrimit të bërë në një sistem të teknologjisë së informacionit. Ka specialistë të fushës, ndër ata emra që janë aty, funksionarë të Drejtorisë së Votimit nga Jashtë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për sa i takon...

**Znj. H. Vukaj:** Të gjithë janë të profesionit IT?

**Znj. J. Josifi:** Jo të gjithë, tre janë të tillë, aty.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

**Znj. H. Vukaj:** Është pjesë e dosjes vlerësimi që ata kanë bërë dhe arsyeja, argumenti pse kanë zgjedhur këtë kriter dhe jo një kriter tjetër?

**Znj. J. Josifi:** Nuk janë kriteret.

**Znj. H. Vukaj:** Në një aspekt për shembull?

**Znj. J. Josifi:** Nuk janë kritere të parashikuara, në kuptimin e kritereve të legjislacionit specifik për prokurimin publik, janë thjesht kërkesa teknike funksionale.

**Znj. H. Vukaj:** Pikërisht pra.

**Znj. J. Josifi:** Sa i takon çështjes për të tërhequr ose jo projektaktin, me autorizim të Komisionerit, mund të rideklaroj në seancë që ai nuk do ta tërheqë projektvendimin që ka përcjellë për shqyrtimin edhe miratimin tuaj. Nëse vlerësohet dhe është mundësia, patjetër Komisioneri për ato kompetenca që nuk janë të shprehura, që në Kod nuk janë të dhëna shprehimisht për Komisionin Rregullator, patjetër mund të nxjerrë akte të tij nënligjore, të karakterit administrativ të këtij procesi etj., por jo sa i takon karakteristikave teknike të sistemit. Prandaj dhe keni sot këtë projektvendim për shqyrtimin tuaj. Projektvendimi, më lejoni vetëm të saktësoj një gjë, një aspekt në kuptimin të tekstit, të ndryshimit që ai ka sot, nga aneksi 1 që ishte parashtruar për shqyrtimin tuaj në projektvendimin e kaluar. Duke qenë se në bazë të propozimit tuaj, por dhe vendimit më pas, u transpozua në pikën 7, të kreut 2 të vendimit nr.10, fjalia e fundit “KQZ-ja miraton me akte, parimet, karakteristikat e përgjithshme teknike” dhe me propozimin tuaj, me miratimin e

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

Komisionit Rregullator, kërkohen karakteristika e përgjithshme, teknike për krijimin, funksionimin, administrimin, mbikqyrjen dhe auditimin e PER, sipas legjislacionit në fuqi. Ky tekst që keni sot, pra projektvendimi, në ndryshim nga aneksi, i ka këto hapa të specifikuar.

**Z. M. Çakaj:** Kisha një pyetje. Atëherë, jam i qartë për gjykimin dhe vlerësimin tuaj lidhur me kompetencën si dhe lidhur me kuadrin, bazën ligjore që ju keni përdorur. Atëherë, pyetja ime konsiston në: ju gjykoni dhe vlerësoni se konkretisht në kreun 2.2 “Rregulla për funksionimin e PER”, pika “g”, “Të lejojë nxjerrjen automatike të informacionit nga dokumenti fizik i identifikimit dhe leximin e Kodit dhe dymensionale të bar-ave për të krahasuar informacionin e koduar me të dhënat e printuara. Si dhe pika “n”, “Të përdorë protokollin e sigurisë së shtresës së transportit (tls) 1.2, për të siguruar komunikimet me platformën qendrore të KQZ-së”. Ju mendoni se është karakteristikë themelore e funksionalitetit dhe nëse po mund të na e detajoni pak më shumë?

**Znj. J. Josifi:** Po kur të kalojmë në shqyrtimin pikë për pikë të projektvendimit se jemi në diskutimin në parim.

**Z. M. Çakaj:** Jo.

**Znj. I. Nano:** Pyet tani sepse janë të lidhura këto, nuk është çështje...

**Znj. J. Josifi:** Po nëse i kalojmë përmbajtjes do duhet të shqyrtojmë pikë për pikë projektvendimin!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

**Znj. I. Nano:** A mund të përgjigjeni në këtë moment znj. Josifi?

**Z. M. Çakaj:** Tani çështja shtrohet që përpara se të kalojmë aty, dakord jemi. Po ka një rregullore se si organizohet dhe funksionon ky Komision, ka një procedurë për votimin e aktit. Megjithatë, për të kuptuar më tej dhe për të kuptuar qartë qasjen që ka pasur administrata dhe Komisioneri dhe Komisioneri në propozimin e këtij akti. Nëse do të kisha një përgjigje lidhur me këto dy?

**Znj. J. Josifi:** Është karakteristikë teknike që nuk lidhet me funksionimin e para është për sigurinë. Ju lutem më thoni dhe njëherë, ndjesë, pikat, dy pikat?

**Z. M. Çakaj:** Atëherë, në kreun 2.2, pika “g” dhe pika “n”, po deshe i rilexoj.

**Znj. J. Josifi:** Jo, s’ka gjë, e kuptoj.

**Z. M. Çakaj:** Ta riformuloj pyetjen ose ta ripërsëris? Ju mendoni se këto të dhëna, në pikën “g” dhe “n” përcaktojnë karakteristikat themelore të funksionalitetit të platformës elektronike? Apo është procedura se si komunikon platforma me KQZ-në ose se si përdoret platforma? Se janë, në gjykimin dhe në vlerësimin tim janë dy gjëra të ndryshme. Si përdoret platforma? Si operon platforma ose cilat do të ishin karakteristikat themelore të funksionalitetit? Në gjykimin dhe vlerësimin tim. Megjithatë, sigurisht që ka dhe shumë përkufizime të cilat, në gjykimin dhe vlerësimin tim janë të karakterit të përgjithshëm teknik, rregullator.

**Znj. J. Josifi:** E kuptova qartë pyetjen, domethënë ka disa gjëra që ju i vlerësoni si elementë të përgjithshëm që mund të qëndronin në një akt rregullator dhe të tjera të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

detajuara. Sa i takon shkronjës “g”, të kreut 2.2, “Të lexojë nxjerrjen automatike të informacionit nga dokumenti fizik i identifikimit dhe leximin e kodeve dydimensionale të bar-rave për të krahasuar informacionin e koduar në të dhënat e printuara”, lidhet në fakt me vendimin tuaj nr.10, kreu 4, “Shqyrtimi i kërkesave dhe regjistrimi i zgjedhësve nga jashtë vendit”, pika 2, shkronja “b”, “PER automatikisht verifikon përputhshmërinë e të dhënës biometrike të identifikimit” siç parashikohet në pikën 1, shkronja “b” të kreut 3.1 të këtij vendimi, me foton e skanuar të dokumentit të identifikimit sipas pikës 3, shkronja “a”, të kreut 3.2 të këtij vendimi. Shkronja “g”, e projektvendimit që keni sot për shqyrtim bën pikërisht këtë thotë praktikisht në terma teknike, që PER do duhet ta lexojë, pra ta marrë foton nga dokumenti i identifikimit, në mënyrë automatike, pra ta lexojë foton. Kjo është kuptimi i shkronjës “g”. E mirëkuptoj nëse termat e përdorur janë teknike por është përkthyer ky parashikim i vendimit nr.10, në shkronjën “g”.

**Z. M. Çakaj:** E qartë, ideja ishte që ne kur e miratuam atë nen autorizues, së pari ne donim të krijojmë një sërë rregullash, apo një sërë karakteristikash teknike të përgjithshme, një sërë karakteristikash teknike në dhe posaçërisht jemi shprehur që KQZ do të miratojë me akt, akte. Pasi jo të gjitha aktet mund të ishin të natyrës rregullatore, pra mund të kishte nevojë për më shumë se një akt, mund të kishte nevojë për disa akte, mund të kishte nevojë për një akt me natyrë rregullatore, disa akte të tjera, ku në gjykimin dhe vlerësimin tim, mund të gjenin vend dhe këto procedura konkrete ose gjithë kjo terminologjia teknike, megjithatë nëse ju e keni vlerësuar këtu. Nëse e kalojmë, nëse kolegët bien dakord, nëse e miratojmë në parim dhe do të kalojmë në diskutimet nen për nen apo pikë për pikë, unë do doja të ndalesha posaçërisht në secilën pikë. Të cilat në gjykimin dhe në vlerësimin tim do

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

të kenë nevojë për pak më shumë detajim. Ose mund të mos jetë e natyrës rregullatore. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Dakord.

**Znj. J. Josifi:** Jo për mea culpa të përzierjes së parimeve rregullatore me ato teknike, por me të drejtë në mbledhjet tuaja të para, për rregullat e regjistrimit, ju ngritët çështjen që duke qenë se ky sistem mund të ketë të dhëna sensitive do t'i shërbejë hapjes praktikisht të procesit të votimit, sepse e paraprihet nga ky regjistrim dhe do duhet të kishim garanci në shumë terma, në administrim, kush do bënte çfarë, në çështje të sigurisë. Ndoshta ndonjë nga këto rregulla ose ndonjë nga këto pika, në këtë projektvendim mund të jetë vërtet shumë teknik, por ne nuk donim të linim asgjë jashtë për të qenë korrekt, ky ishte qëllimi në narrative.

**Znj. I. Nano:** Atëherë kolegë për procedurë, z. Çaka vijoni të jeni në linjë me ne?

**Z. D. Çaka:** Po, vazhdoj, zonja Kryetare.

**Znj. I. Nano:** Kolegë, kemi një propozim të z. Çaka për të shpallur moskompetencën e Komisionit Rregullator lidhur me shqyrtimin e këtij projektvendimi. Padyshim, që shqyrtimi i projektvendimit do të vijë dhe duhet të vijë në një moment tjetër, pra nëse vlerësojmë që po e kemi kompetencën, atëherë do mund të shqyrtojmë aktin. Në këtë moment kemi një koleg që kërkon pikërisht këtë gjë dhe më duhet ta votoj dhe do doja të thoja që dhe unë pak a shumë e mbështes këtë propozim. Nga ana e administratës nuk kemi diçka tjetër për të shtuar? Të vijoj me procedurën sepse ju

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

shtruan disa pyetje. Dakord s'keni autorizim për të bërë diçka të ndryshme nga sa po thoni apo po bëni.

**Znj. P. Doçaj:** Jo, ideja është që duke qenë se ne e kemi propozuar në tërësi në të gjitha pikat e vendosura në akt, mendojmë se janë kompetencë e Komisionit Rregullator në tërësi.

**Znj. I. Nano:** Dakord.

**Znj. P. Doçaj:** Nëse, kur t'i hyjmë themelit të çështjes, atëherë do t'i qartësojmë.

**Znj. I. Nano:** Dakord. Atëherë z. Çaka e ripërsërisni propozimin tuaj ju lutem?

**Z. D. Çaka:** Po, atëherë propozoj votimin e moskompetencës së Komisionit Rregullator për shqyrtimin e projektaktit të sjellë nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, "Për miratimin e karakteristikave themelore të funksionalitetit të platformës elektronike për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë". Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit z. Çaka! Atëherë kolegë kalojmë në votimin e propozimit të kolegut Çaka. Kush është dakord për shpalljen e moskompetencës së Komisionit Rregullator për shqyrtimin dhe miratimin e këtij vendimi. Z.Çaka do duhet të thuash me zë. Unë jam dakord, z. Çela është dakord.

**Z. D. Çaka:** Unë jam dakord për moskompetencën e Komisionit Rregullator.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

**Znj. I. Nano:** Kush është kundër? Dy vota kundër.

**Kush është dakord?**

**Pro: 3 (znj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela)**

**Kundër: 2 (znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)**

**Nuk miratohet!**

Atëherë nuk miratohet propozimi i z. Çaka për shpalljen e moskompetencës së Komisionit Rregullator. Kështu që do të duhet të fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit. Znj. Josifi në mënyrë shumë të përmbledhur, se ne arritëm të kalonim edhe në detaje, shumë përmbledhtas një prezantim të projektvendimit.

**Znj. J. Josifi:** Faleminderit! Atëherë, meqë diskutimin për çështjen e kompetencës e tejkaluam, po kaloj direkt në relatimin e përmbajtjes së projektaktit. Ky projektakt ka për qëllim të përcaktojë karakteristikat themelore të krijimit, administrimit, funksionimit, mirëmbajtjes, mbikqyrjes dhe auditimit të platformës elektronike për regjistrimin e kërkesave të zgjedhësve nga jashtë vendit, nga këtu e në vijim referuar si PER. Në kreun e parë të këtij projektvendimi parashikohen rregullat të përgjithshme, janë praktikisht ato që janë të përcaktuara në ligj. Sa i takon shfaqjes së vullnetit të zgjedhësit nga jashtë për t'u regjistruar në listën jashtë vendit dhe mënyrës se si kjo kërkesë bëhet përmes kësaj platforme. Ndërkohë që rregullat tashmë janë miratuar për regjistrim, janë ato të përcaktuara në aktin përkatës të Komisionit Rregullator. Në kreun 2 kemi parashikuar rregullat që lidhen me krijimin, administrimin dhe funksionimin e kësaj platforme si dhe rregullat për shqyrtimin e kërkesave. Ky kre është i ndarë në disa nënkre. PER do të jetë një platformë që do të mund të jetë e aksesueshme dhe të përdoret në të dy versionet, siç e kemi thënë dhe në vendimin e mëparshëm të Komisionit Rregullator, në versionin desktop, ashtu edhe mobile, pakushtëzim për nga teknologjia e zgjedhësi për ta

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

aksesuar atë. Në zbatim të kuadrit rregullator në fuqi, në Republikën e Shqipërisë për mbrojtjen e të dhënave personale, të gjithë të dhënat e administruara nga ky sistem do të duhet të mbetet në pajisje të përdoruesit, pajisjet përkatëse si dhe qendrën e të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Praktikisht nga pikëpamja funksionale kjo platformë do të ketë dy komponentë, është ai i regjistrimit, pra është komponenti që do të përdoret nga zgjedhësi për të bërë kërkesën për regjistrim dhe për të verifikuar identitetin dhe nga ana tjetër është moduli ose komponenti i shqyrtimit të këtyre kërkesave. Është praktikisht ajo pjesë e platformës e cila përdoret nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për të shqyrtuar kërkesat e ardhura nga zgjedhësit dhe për të verifikuar informacionin. Për funksionalitetin e PER, ne kemi parashtruar disa kërkesa teknike si një dysheme, pra kërkesa minimale, teknike për këtë sistem. Nuk po i rendis pikë më pikë tani, por po ndalem tek pikat që do të kenë nevojë për shpjegime, nëse e gjykoni kështu. Nga ana tjetër në projektakt përcaktohen rregullat teknike lidhur me shqyrtimin e kërkesave, që janë praktikisht përkthim i dispozitave të vendimit tuaj nr.10, të kreut 4, nga pikëpamja teknike. Ndërkohë në kreun 3 të këtij projektvendimi janë përcaktuar rregullat në lidhje me mirëmbajtjen, mbikqyrjen dhe auditimin e PER, ku janë marrë parasysh kërkesat ligjore të legjislacionit në fuqi, sa i takon mirëmbajtjes të sistemeve të teknologjisë së informacionit, që krijohen për herë të parë nga institucionet publike. Sa i takon mbikqyrjes dhe auditimit jemi bazuar në parashikimet e Kodit Zgjedhor. Ky projektvendim është publikuar për konsultim gjatë javës së shkuar. Kemi marrë mendime me shkrim nga znj. Anila Smorgrav (Hyka), përfaqësuese Këshillit Koordinues të Diasporës, opinionet e së cilës në plan teknik janë të cituara në relacion dhe janë reflektuar në projektvendimin që është përcjellë pranë jush. Për sa më lart në këtë relacion Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve brenda kompetencave të veta, në respektim të detyrimeve dhe afateve

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

ligjore të përcaktuara në Kodin Zgjedhor ju propozon për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për miratimin e karakteristikave themelore të funksionalitetit të platformës elektronike për regjistrimin e zgjedhësve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”. Faleminderit!


**Znj. I. Nano:** Faleminderit znj. Josifi! Fillojmë me shqyrtimin, diskutimin në parim të projektvendimit. Kolegë keni diçka? Përfaqësuesit e partisë politike? Zoti Çaka që jeni larg?

**Z. D. Çaka:** Po. Atëherë, duke qenë se e kam pak të pamundur për shkak të largësisë, do të doja që në fillim duke qenë se po shqyrtojmë në parim këtë projektvendim. I qëndroj atij arsytimi që bëra dhe më parë, që u hodh në votim nga kolegët, propozim i cili nuk u miratua dhe nëpërmjet kësaj shprehje unë dua të jap, shpreh votën time kundër. Duke e argumentuar pikërisht në të njëjtën pjesë arsytuese që unë besoj që nuk është kompetencë e jona shqyrtimi i draftit dhe duke qenë se jemi në... Pastaj duke qenë se rregullorja e Komisionit Rregullator e ka përcaktuar, do doja që një kërkesë për administratën, në momentin që bëhet e mundur zbardhja e aktit sidoqoftë vendimmarrja, vota ime do të jetë kundër në parim, ta kisha si pjesë arsytuese, të shprehjes, pra shpjeguese, të votës sime në vendim. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit z.Çaka! Nëse nuk ka diskutime në parim kalojmë në votimin në parim të projektvendimit. Kush është dakord në parim kolegë? Zoti Çaka e shprehu.

**Z. D. Çaka:** Kundër!

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 04.11.2024*

**Znj. I. Nano:**

***Kush është dakord?***

***Pro: 2 (zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: 3 (zgj. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela)***

***Nuk miratohet!***

Atëherë 2 vota janë pro miratimit në parim, 3 kundër, për koherencë për të njëjtin arsyetim pse e vlerësova që nuk kemi kompetencë për të njëjtën arsye e votoj kundër në parim. Meqenëse nuk miratohet në parim projektvendimi nuk mund të kalojmë nën për nën. Çështje tjetër jashtë rendit të ditës nuk kemi, kështu që mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

**Vendimi nr. 12**

***Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA***

